

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: Ari Med L.L.C., Rr. Enver Maloku nr. 22, 10000, Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	24.12.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **24.12.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Ari Med L.L.C.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së: Lot 2 – Furnizim me material reagensa shpenzues për Laborator**, me Numër të prokurimit: **623-24-11352-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-064-1-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET e pa bazuar** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Ari Med L.L.C.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së: Lot 2 – Furnizim me material reagensa shpenzues për Laborator**, me Numër të prokurimit: **623-24-11352-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-064-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **19.12.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-11352-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-064-1-1-1**
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Ari Med L.L.C.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së: Lot 2 – Furnizim me material reagensa shpenzues për Laborator**, me Numër të prokurimit: **623-24-11352-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-064-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **19.12.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **24.12.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua Ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

ARSYETIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit, në vlerë jo më pak se: LOT II 263,000.00 €uro;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1: Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar në Kosovë;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, keni prezantuar një **Raporte Bankar nga NLB Bank**, ku pasqyron që qarkullimi i juaj është në vlerë prej: **221,639.60 €**, ndërsa sipas Njoftimit për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), **për Lot II** është kërkuar në vlerë jo më pak se: **263,000.00 €**;

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, kemi shembullin se si duhet vepruar:

Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	68
---	---	----

Andaj oferta juaj konsiderohet e **papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së;**

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. LOT II 197,500.00 Euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1: Lista e furnizimeve të kryera, duke plotësuar ANEKSIN 7 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e furnizimeve të ngjashme, të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca/t ose procesverbalit/et e pranimit të furnizimeve, Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca që janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare ose ndërkombëtare, atëherë ato duhet të prezantoj transaksionin bankar, që përputhet me të Njëjtën kontratë – Referencë;

Sqarimet janë si në vijim:

Referenca/t ose procesverbalit/et e pranimit të furnizimeve, në lëmin e furnizimeve të ngjashme, të prezantuar nga juaj, janë në vlerë prej: **19,980.00 Euro**, ndërsa sipas Njoftimit për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), për Lot II është kërkuar në vlerë jo më pak se: **197,500.00 €**;

Po ashtu në ofertën tuaj të dorëzuar, keni prezantuar Referencat me subjekte, por nuk i keni bashkangjitur dëshmitë, të specifikuara tek Dëshmisë Nr. 1 të Kapacitetit teknik dhe profesional, ku thotë: Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca që janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare ose ndërkombëtare, atëherë ato duhet të prezantoj transaksionin bankar, që përputhet me të Njëjtën kontratë – Referencë;

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, kemi shembullin se si duhet vepruar:

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	69
--	--	----

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së;

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 1 citoj:

- Data e Njoftimit per kontrate: 31.10.2024
- Data e hapjes se Ofertave: 25.11.2024 / 14:00h
- B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara: 06.11.2024
- B85 - Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues: 19.12.2024
- Kërkesa per qasje ne dokumentet per fituesin nga OE: 19.12.2024
- Qasja e lejuar: 23.12.2024

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 1:

Me datë: 19.12.2024, në Ora: 4:47 PM (jashtë orarit Zyrtar të Punës), kemi bërë kërkesë për qasje:

(Shih emailin e bashkangjitur):

From: Jetmir Sherifi <arimed.ks@gmail.com>
Sent: Thursday, December 19, 2024 4:47 PM
To: Prokurimi Rahovec <Prokurimi.Rahovec@rks-gov.net>
Subject: Kërkes për qasje ne dokumentet zyrtare per fituesin per Lotin 2.

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Per Tenderin me numer te porkurimit 623-24-11352-1-1-1 me titull FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKESOR PER NEVOJAT E QKMF-së, kërkojme qasje ne dokumentet zyrtare per fituesin per Lotin 2.

Ju lutem, na njoftoni per ditën, dhe orën e qasjes per kete procedur.

Me respekt

Me datë: 20.12.2024, ne si AK: Komuna e Rahovecit, ju kemi lejuar qasje, duke cekur:

(Shih emailin e bashkangjitur):

Prokurimi Rahovec

From: Prokurimi Rahovec
Sent: Friday, December 20, 2024 1:31 PM
To: 'Jetmir Sherifi'
Subject: RE: Kërkes për qasje ne dokumentet zyrtare per fituesin per Lotin 2.

Te nderuar!

Ju mund të keni qasje kur ju dëshironi nga data: **20.12.2024 dhe çdo ditë pune**, nga ora: 08:30 h deri ne: 15:30 h, në Zyrën e Prokurimit – Komuna e Rahovecit

Me respekt
Zyra e Prokurimit Rahovec

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 2 citoj:

Pika 1 e Ankeses - OE i njoftuar per dhenje te kontrates **Grupin e OE BRT Pharm SH.P.K dhe N.SH.T Neramed**. Nuk kan ofruar Autorizim nga prodhuesi ose dilleri i Autorizuar per produktet e pozicionuara 65,66 dhe 67 sipas kerkeses se AK dhe FDT. Gjithashtu mungojne Broshurat, se bashku me nje pershkrim te Specifikimit teknik siq kerkohet ne FDT.


OE i njoftuar per kontrate kan ofertuar me produkte te cilat nuk perkojne me reagencat e kerkuara per keto tri pozicione dhe nuk jane kompatible me paisjen qe posedon QKMF ne Rahovec. Ata kan ofertuar me reagenca jo origjinale dhe te cilat nuk mund te implementohen ne paisjen sipas specifikave te kerkuara nga Njesia Kerkuese dhe AK.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2:

Lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar.

Në Procesverbalin e Qasjes në Dokumentet e Kërkuar në bazë të Kërkesës tuaj, keni pranuar këto dokumente:

(Shih emailin e bashkangjitur):



Gjatë procesit të vlerësimit, në bazë formularit **B47 Letër Standarde e kërkesës per sqarimin e tenderit** kemi kërkuar sqarime për Operatori Ekonomik të Rekomanduar për Kontratë, duke cekur:

Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 72 kërkoj sqarime shtesë ku thotë:

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji;

Në bazë të **Formularit standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara**, të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik, të datës: 05.11.2024, **kemi kërkuar:**

• **Kërkesa per LOT 2: Për produktet e renditura ne pozicionin Nr. 65, 66 dhe 67, Prezantimi i produkteve te ofruara me katalogë/broshura;**

• **Dëshmia:** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë/broshura nga prodhuesi i këtyre furnizimeve për produkte e renditura ne pozicionin Nr. 65, 66 dhe 67, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siq kërkohet në specifikimet teknike;

- **Në ofertën e juaj të dorëzuar, NUK keni ofruar katalogë/broshura, për produktet e renditura ne pozicionin Nr. 65, 66 dhe 67 të LOT2;**

Ne si Autoritet Kontraktues: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni informacionet qe mungojnë, në bazë të sqarimeve te lartcekura, duke u bazuar në nenin 72;

• **Kërkesa per LOT 2:** Për produktet e renditura ne pozicionin Nr. 65, 66 dhe 67, Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për shtijën e këtyre produkteve;

• **Dëshmia:** Te dëshmohet se Operatori është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për shtijën e këtyre produkteve, Autorizimi duhet te jetë me numër te prokurimit si me lart, (me te dhëna detaje te kontaktit për prodhuesin: adresa, websajti, numri i telefonit, emali);

Në ofertën e juaj të dorëzuar, keni prezantuar **LETTER OF AUTHORIZATION**, nga përfaqësuesi i Autorizuar nga Prodhuesi:

- **GENIUS KOSOVA SHPK**
- **STR. BAJRAM KELMENDI**
- **70000 FERIZAJ**
- **KOSOVO**

Në dokumentacionin e prezantuar, është dorëzuar **AUTHORZATION**, nga **GESAN**

PRODUCTION SRL, i datës: **06/05/2022**, ku në këtë Autorizim ceket: This authorization is valid for 2 (two) years from the date of issue for the below products;

Ne si Autoritet Kontraktues: **Komuna e Rahovecit**, kërkojmë të na sqaroni se përfaqësuesi i Autorizuar nga Prodhuesi: **GENIUS KOSOVA SHPK - Ferizaj**, a e ka të vazhduar Validitetin nga Prodhuesi: **GESAN PRODUCTION SRL**;

Po ashtu kërkojmë të na dorëzoni një Deklaratë nga Prodhuesi: **GESAN PRODUCTION SR**, se kjo kompani a është prodhuesi për produkte:

- **ACCESS TSH (3rd IS) 2x100 DET;**
- **ACCESS TOTAL T4 2X50 DET;**
- **ACCESS TOTAL T3 2X50 DET;**

Pasi që në linkun e prezantuar: **GESAN PRODUCTION SR**,

<https://www.gesanproduction.it/wp-content/uploads/2023/12/Gesan-product-list-2023.pdf>

Ne si Autoriteti Kontraktues, nuk kemi mundur te verifikojmë që kjo Kompani është prodhuese për këto produkte, andaj kërkojmë: Deklaratë nga Prodhuesi: **GESAN PRODUCTION SR**;

Operatori Ekonomik i Rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar të gjitha dokumentacionet e kërkuara në bazë të kërkesës per sqarimin e tenderit, ku në sqarimet e dhëna nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, janë gjithësie tridhjetë e dy (32) faqe sqaruese, duke plotësuar këtë kriter te kërkuar ne bazë të Formularit për Korrigjimi (B54);

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 3 citoj:

Pika 2 e Ankeses - Gjithashtu, **Grupi i OE BRT Pharm SH.P.K dhe N.SH.T Neramed** nuk ka dorzuar dokumentin per Specifikacionin Teknik, Dokumentin Aneks 1 sipas nenit 3.1 te Dosjes se Tenderit (Specifikacionet teknike te detyrueshme). Ne mungese te ketij dokumenti , oferta duhet te refuzohet.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 3:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar.

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë, i ka plotësuar të gjitha Kërkesat dhe Dëshmitë e kërkuar në **Njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e tenderit;**

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;

Në bazë të B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, është kërkuar:

Kërkesa per LOT 2: *Për produktet e renditura ne pozicionin Nr. 65, 66 dhe 67, Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për shtijën e këtyre produkteve; Dëshmia: Te dëshmohet se Operatori është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për shtijën e këtyre produkteve, Autorizimi duhet te jetë me numër te prokurimit si me lart, (me te dhëna detaje te kontaktit për prodhuesin: adresa, websajti, numri i telefonit, emali);*

Në Ofertë e juaj të dorëzuar si Operator Ekonomik Ankues, keni prezantuar: Autorizimi nga përfaqësuesi i autorizuar, në këtë rast përfaqësuesi i autorizuar është Kompania: **AtomMed – Ferizaj**, ku kjo kompanie, nga data: **25/10/2024** deri më: **24/01/2025**, është në Tabelën e Operatorëve Ekonomik të diskualifikuar (**Lista e Zezë**) nga **Organi Shqyrtues i Prokurimit;**

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Komuna e Rahovecit